



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 166, Datë 15.08.2024

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 135, DATË 09.07.2024
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “5GX ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.08.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1731/1 prot., datë 07.08.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 135, datë 09.07.2024, ka vendosur të licencojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier për një afat 30-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 01.08.2024.
- Në pikën 2 të këtij vendimi i është lënë kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe/ose amendimin e kontratës së nënshkruar, për kërkesën e bërë nga shoqëria për ndryshimin e vlerës së investimit të projektit.
- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 866/8 prot., datë 15.07.2024, ku i ka kërkuar dhe të mbajë në konsideratë sa përcaktuar në këtë vendim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1731 prot., datë 05.08.2024, shoqëria ka depozituar në ERE Kontratën nr. 2966 rep., nr. 642 kol., datë 02.08.2024, “Për disa ndryshime të kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.06.2023 Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 10 MW, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier nga shoqëria “5GX ENERGY”

shpk”, nënshkruar mes MIE dhe mbajtësit të miratimit për ndërtim, shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k., në të cilën është ndryshuar vlera e investimit të projektit sipas planit të rishikuar të biznesit të shoqërisë.

- Me depozitimin e kësaj kontrate shtesë rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE nr. 135 datë 09.07.2024, ndaj si e tillë kjo pikë vlerësohet të shfuqizohet.
- Me plotësimin e këtij kushti nuk gjen më zbatim as pika 3 e vendimit të bordit të ERE nr. 135/2024, si e tillë kjo pikë vlerësohet të shfuqizohet.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, apo ndryshimin e tij, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 135, datë 09.07.2024, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “5GX ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI